VENDIM EKSTRAKT

Për kriterin e pranueshmërisë nenin 120 pika 1, shkronjat "ç"

Ankuesi i është drejtuar Inspektorit të Lartë të Drejtësisë me ankesat, në të cilat ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të magjistratëve me detyrë gjyqtar pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, në kohën e kryerjes se shkelja së pretenduar.

Në përmbajtje të ankesave, ankuesi parashtron se në vitin 2018 ka paraqitur pranë Gjykatës së Rrethit Gjyqësor kërkesëpadi ndaj shtetasit X me detyrë avokat, me objekt "Kthimin e një shume monetare". Sipas ankuesit, gjykata ka vendosur detyrimin e të padituri për t'i kthyer shumën të dhënë si hua, së bashku me kamatëvonesat deri në ditën e ekzekutimit të vendimit. Më datë 31.10.2018, ka deklaruar të falsifikuar shkresën "Aktmarrëveshje", të datës 10.02.2022, lidhur ndërmjet palëve, si dhe i ka kërkuar prokurorisë fillimin e procedimit penal ndaj shtetasit X.

Ankuesi parashtron se, në kuadër të procedimit penal, Prokuroria pranë Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm, me shkresë ka njoftuar për përfundimin e hetimeve, ndërsa më datë 01.06.2022 është zhvilluar seanca gjyqësore për shqyrtimin e kërkesës së prokurorisë për dërgimin e çështjes në gjyq. Sipas ankuesit, pas zhvillimit të disa seancave gjyqësore, gjyqtarja me vendimin e datës 29.06.2022, ka vendosur kthimin e akteve prokurorisë për plotësimin e hetimeve dhe më pas ka dhënë dorëheqjen nga detyra e gjyqtarit.

Në vijim të gjykimit, çështja i ka kaluar gjyqtarit i cili, me vendimin datë 18.07.2023, ka vendosur pezullimin e gjykimit deri në përfundimin e gjykimit të çështjes civile pranë Gjykatës së Apelit. Ankuesi pretendon se ky vendim është në kundërshtim me ligjin dhe ka sjellë zvarritjen e gjykimit të çështjes penale. Gjithashtu, ai parashtron se vendimi i pezullimit nuk i është vënë në dispozicion për një periudhë të gjatë kohore dhe se është zbardhur më datë 19.03.2024. Sipas ankuesit, ndaj këtij vendimi është ushtruar ankim nga i pandehuri dhe Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, me vendimin, datë 01.10.2024, ka vendosur ndryshimin e vendimit të gjykatës së shkallës së parë, duke hequr pezullimin e gjykimit të çështjes penale dhe urdhëruar vazhdimin e saj.

Nga aktet e administruara rezulton se vendimmarrja e gjyqtarit për pezullimin e gjykimit është bërë objekt kontrolli nga Gjykata e Apelit e Juridiksionit të Përgjithshëm, e cila, me vendimin e sipërcituar, ka vendosur ndryshimin e vendimit të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Ankuesi pretendon se, si pasojë e vendimmarrjes së gjyqtarit, çështja penale ka mbetur e pezulluar për një periudhë të gjatë, duke sjellë zvarritjen e procesit.

Inspektori i Lartë i Drejtësisë, në ushtrim të kompetencave të tij ligjore, shqyrton ankesat ndaj magjistratëve në përputhje me parashikimet e pjesës V, kreu II, të ligjit nr. 96/2016, "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar, si dhe me dispozitat përkatëse të ligjit nr. 44/2015, "Kodi i Procedurave Administrative i Republikës së Shqipërisë".

Në nenin 120 të ligjit "Për statusin" parashikohet se ankesa për t'u pranuar për shqyrtim dhe

për të vijuar me verifikimin dhe/ose hetimin disiplinor duhet të përmbushë kriteret e përcaktuara shprehimisht nga pika 1, shkronjat "a" deri "dh" të këtij neni. Konstatimi i mospërmbushjes së njërit ose më shumë prej këtyre kritereve passjell arkivimin e ankesës.

Nga shqyrtimi fillestar i ankesës referuar kritereve për pranueshmërinë e saj të parashikuara nga neni 120 i ligjit "Për statusin", rezulton se ankesat janë paraqitur në formën e përcaktuar në nenin 120, pika 1, shkronja "a" të këtij ligji, pasi përmbajnë gjeneralitetet e ankuesit dhe adresën e tij, përshkruajnë rrethanat e faktit që pretendohen të kenë ndodhur, si dhe përmbajnë emrin dhe mbiemrin e magjistrateve dhe gjykatën pranë së cilës këto magjistrate kanë ushtruar funksionin. Për rrjedhojë, plotësohet kriteri i pranueshmërisë i parashikuar në nenin 120, pika 1, shkronja "a" të ligjit "Për statusin".

Për sa i përket kriterit të pranueshmërisë lidhur me afatin e parashkrimit, parashikuar kjo në shkronjën "b", pika 1, të nenit 120 të ligjit "Për statusin", plotësimi i këtij kriteri vlerësohet në raport me parashikimet e nenit 117 të këtij ligji, ku sipas këtij neni shkeljet disiplinore parashkruhen brenda 5 viteve. Nga përmbajtja e ankesës konstatohet se pretendimet e ngritura i referohen shqyrtimit të çështjes penale të gjykuar me vendimin e datës 18.07.2023, të Gjykatës së Shkallës së Parë të Juridiksionit të Përgjithshëm. Për rrjedhojë ankesa plotëson kriterin e pranueshmërisë të parashikuar në shkronjën "b", pika 1, të nenit 120 të ligjit "Për statusin", pasi është paraqitur brenda afatit 5-vjeçar të parashkrimit.

Ankesat nuk përmbajnë elementë abuzivë, nuk janë haptazi të pabazuara ose të përsëritura nga i njëjti ankues dhe për këto ankesa nuk ka një vendimmarrje të mëparshme të Inspektorit të Lartë të Drejtësisë. Për rrjedhojë ato përmbushin kriteret e pranueshmërisë së ankesës të parashikuara në shkronjën "c", të pikës 1, të nenit 120 të ligjit "Për statusin".

Lidhur me pretendimet ndaj magjistratit nga verifikimi i informacionit të publikuar në faqen zyrtare të Këshillit të Lartë Gjyqësor ka rezultuar se është vendosur deklarimi i mbarimit të statusit të magjistrateit për shkak të dorëheqjes nga detyra. Gjithashtu, Komisioni i Pavarur i Kualifikimit, ka vendosur ndërprerjen e procesit të rivlerësimit kalimtar për këtë subjekt.

Në kushtet kur magjistrati nuk e gëzon më statusin e magjistratit, nuk mund të jetë më subjekt i veprimtarisë së Inspektorit të Lartë të Drejtësisë në kuptim të nenit 147/d të Kushtetutës dhe dispozitave përkatëse të ligjit nr. 96/2016.

Për rrjedhojë, ankesat, për sa u përket pretendimeve ndaj ish-magjistratit, nuk përmbushin kriterin e pranueshmërisë të parashikuar në nenin 120, pika 1, shkronja "ç", të ligjit nr. 96/2016

PËR KËTO ARSYE

Bazuar në nenin 120, pika 1, shkronja "ç", nenin 121, pika 2, shkronja "a" të ligjit nr. 96/2016 "Për statusin e gjyqtarëve dhe prokurorëve në Republikën e Shqipërisë", i ndryshuar dhe nenin 214 të ligjit nr. 115/2016 "Për organet e qeverisjes së sistemit të drejtësisë", i ndryshuar,

VENDOSA

1. Arkivimin pas shqyrtimit fillestar të ankesave të bashkuara të paraqitura nga ankuesi në të cilat ngrihen pretendime ndaj veprimtarisë gjyqësore të ish-magjistratit.
2. Në zbatim të nenit 121, pika 3 të ligjit "Për statusin", ky vendim t'i njoftohet ankuesit brenda 5 (pesë) ditëve nga marrja e tij.
3. Kundër këtij vendimi ankuesi mund të paraqesë ankim në Këshillin e Lartë Gjyqësor, brenda 1 (një) jave nga marrja e këtij vendimi.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë